



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 30/4, DATË 14/02/2018

PËR MIRATIMIN ME KUSHT TË STATUSIT "INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË" PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT ME POTENCIAL STRATEGJIK "GAS POWER PLANT KORÇA" ME SUBJEKT APLIKUES "GPP KORÇA SHPK, NUIS/NIPT: L73724004N"

Në mbështetje të Nenit 9, 17, 18 dhe 22 të Ligjit Nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike", Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Sekretariatit Teknik, vlerësoi mbi projektin aplikues:

- Projekti parashikohet të realizohet nga subjekti "GPP KORÇA SHPK, NUIS/NIPT: L73724004N".
- Projekti parashikon realizimin në zonën e Korçës të një Termocentrali elektrik me gaz me cikël të kombinuar, me rendimet të shndërrimit të energjisë termike në energji elektrike me 60% ose 5990 kj/KWh, me kapacitet 480,9 MW; Impianti synohet të furnizohet me gaz nga projekti i gazsjellësit TAP në sasi 6,36 x 108 m3/vit (distanca 2 km në veri), sipas një kontrate që vetë subjekti propozues do negociojë me kompaninë TAP AG dhe me furnizuesit e gazit; Energjia elektrike e prodhuar synohet të transmetohet tek N/S Elektrik Zëmbllak, duke dalë në treg të lirë me qasje në treg rajonal, pa parashikuar si kusht nënshkrimin e një marrëveshje (PPA) me Qeverinë Shqiptare; Uji për kondensim (në sasinë 460 m3/orë (128 l/s)) parashikohet të merret nga impianti i pastrimit të ujrave të Qytetit të Korçës, ashtu sikundër parashikohet dhe hapja e dy puseve me kapacitet 20-30 l/s secili .
- Projekti në një fazë të dytë zhvillon konceptin e ngrohjes qendrore të qytetit të Korçës, deri në 80 MW energji termike për ngrohje dhe 6 MW për ujë sanitar. Zhvillimi i rrjetit të ujit të nxehtë në të gjithë qytetin synohet të bëhet nga partneriteti publik privat që do të vendoset ndërmjet subjektit GPP Korçë dhe Bashkisë të Korçës.

- Projekti synohet të zhvillohet në një sipërfaqe totale prej 909,182 m² me shtrirje në Korçë, Pojan, Kuç i Zi, Belorta, Dishnicë, Barç, Zëmlak, Malavec, Neviçisht, për realizimin e termocentralit, lidhjes me TAP, lidhjes me sistemin e ujit, ndërtimit të shtyllave të linjës së transmetimit dhe ndëtimin e shtesës së N/S Zëmlak.
- Nga e gjithë sipërfaqja totale prej 909,182 m², sipërfaqja prej 245,208m² nevojitet për përdorim të përhershëm. Në rastin e këtyre pasurive me përdorim të përhershëm deklarohet se nuk do të afektohet asnjë vepër teknike, të tilla si kanale kulluese, kanale vaditëse apo vepra hidroteknike.
- Për sipërfaqet që kërkohet përdorim i përhershëm janë të zërit kadastral “arë” të kategorisë së V (pestë) të bonitetit. Kurse për sipërfaqet që kërkohen të drejtat e servitutit, janë të zërit kadastral “arë” të kategorisë III, IV dhe V të bonitetit.
- Vlera e investimit të projektit “GAS POWER PLANT KORÇA” plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 349.700.000 € (treqind e dyzet e nëntë milion e shtatëqind mijë euro).
- Përgjatë fazës së realizimit të projektit numri i personave të punësuar parashikohet të jetë 400 (katërqind) dhe gjatë fazës së operimit të projektit, numri i personave të punësuar parashikohet të jetë 123 (njëqind e njëzet e tre) persona.
- Projekti nuk mbivendoset me projekte apo aktivitete të tjera, të shqyrtuara më parë.

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Statusit “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Veçantë” për projektin e investimit “Gas Power Plant Korça” me subjekt aplikues “GPP Korça shpk, NUIS/NIPT: L73724004N”. Projekti është në përputhje me Strategjinë Sektoriale për Sektorin e Energjisë dhe Master Planin për Sektorin e Gazit 2016 ku është parashikuar ndërtimi i një TEC-i me gaz me cikël të kombinuar në Zonën e Korçës.
 - a. Aktiviteti i prodhimit të energjisë nga gazi natyror është një projekt që duhet të pajiset me leje mjedisi dhe për këtë qëllim subjekti që të përfitojë nga masat mbështetëse të statusit “Investim/investitor strategjik me procedurë të veçantë” duhet të aplikojë, pas miratimit të VNM, në përputhje me kriteret dhe kushtet e legjislacionit në fuqi, edhe për leje mjedisi në përputhje me kapacitetet prodhuese dhe angazhimet e Qeverisë Shqiptare lidhur me nivelin e emetimit të gazrave.
 - b. Subjekti që të përfitojë nga masat mbështetëse të statusit strategjik “Investim/investitor strategjik me procedurë të veçantë”, duhet të nënshkruajë marrëveshje të garancive financiare prej jo më pak se 10% e vlerës totale të investimit me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në

zbatim të VKM Nr. 1028, datë 16.12.2015 “Për përcaktimin e masave, marzheve, rregullave dhe dokumentacionit të garancive financiare të investimeve strategjike”.

- c. Subjekti për të përfituar masat mbështetëse të statusit strategjik “Investim/investitor strategjik me procedurë të veçantë”, të miratuara nga KIS, duhet të bashkëpunojë me ministrinë përgjegjëse për energjinë, ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe Bashkinë Korçë, në zbatim të planit të veprimit miratuar dhe bashkëlidhur këtij vendimi dhe detyrimeve parashikuar nga legjislacioni sektorial, por pa u kufizuar, respektivisht:
- Ligji Nr.102/2015, datë 23.09.2015, “Për sektorin e gazit natyror”
 - VKM Nr. 713, datë 25.8.2010 “Për përcaktimin e rregullave për kushtet e procedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror”,
 - Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07,2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar;
 - VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.
 - Ligjin Nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës”, të ndryshuar.
- d. Subjekti propozues në rastin e pasurive që kërkojnë përdorim të përhershëm nuk duhet të afektojë asnjë vepër teknike, të tilla si kanale kulluese, kanale vaditëse apo vepra hidroteknike dhe kjo tokë duhet të jetë e mundur, në bazë të legjislacionit, për të realizuar ndryshim të kategorisë së resursit.
2. Statusi strategjik “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Veçantë” i jepet projektit të investimit “Gas Power Plant Korça”, për një periudhë 3 (tre) vjeçare, në përputhje dhe me fazat e realizimit të projektit, parashikuar në studimin e fisibilitetit nga subjekti aplikues.
3. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, masat mbështetëse që i jepen projektit janë si më poshtë:
- a) Kryerje e procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
 - b) Asistencë në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit;
 - c) E drejta për realizimin nga subjekti të infrastrukturës ndihmëse, në përputhje të kriterëve të legjislacionit në fuqi, për sa i përket nevojave për infrastrukturën e linjës së gazit, infrastrukturën e linjës së

transmetimit të energjisë elektrike nga termocentrali deri në N/S Zëmlak dhe infrastrukturën e linjave të ujit.

d) Asistencë për kryerjen e veprimeve në lidhje realizimin e marrëveshjes me OST për lidhjen me rrjetin Shqiptar të transmetimit.

4. Për masën mbështetëse të kërkuar *“Konsolidim toke dhe shpronësim: afërsisht 25 ha shpronësim dhe një sipërfaqe prej 30 ha total së bashku me të drejtën e servitutit”* kjo masë nuk mund të mbështetet nga Shteti Shqiptar, pasi shpronësimi mund të realizohet kur shteti merr përsipër angazhime konkrete për pjesëmarrjen në investim. Masa mbështetëse duhet të bazohet në procedurën e parashikuar në VKM Nr. 1032, datë 16.12.2015 *“Mbi dokumentimin e marrëveshjeve të investitorëve strategjike me pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private”*, sipas të cilës parashikohet se: *“Investitorët strategjik të cilët kanë përfituar statusin “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”, përpara se të kërkojnë shpronësimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga investimi strategjik, duhet të kryejnë dhe dokumentojnë procedurat për arritjen e një marrëveshjeje me pronarët, duke u ofruar atyre instrumente të përshtatshme alternative dhe/ose kompensuese.*
5. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik *“Gas Power Plant Korça”* konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike, ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
6. Ky vendim i njoftohet investitorit si dhe publikohet në regjistrin e investimeve strategjike.
7. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia Korçë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DAMIAN GJIKNURI

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
ARBEN AHMETAJ

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
NIKO PELESHI

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
BLENDI KLOSI

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT
ALMA HICKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

PLANI I VEPRIMIT

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK GAS POWER PLANT KORÇA

Masat e kërkuara	Rekomandimi/Baza ligjore	Detyra shtesë
<p>Ndërtimi i linjës së gazit 2.1 km, e cila do të lidhet me TAP</p>	<p>Rekomandohet PO nga MIE dhe rekomandohet PO me kusht nga MTM.</p> <p>Ligji Nr.102/2015, datë 23.09.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe të VKM Nr. 713, datë 25.8.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për kushtet e procedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror”,</p> <p>Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07,2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, si dhe të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”</p>	<p>Hapat që duhet të ndjekë subjekti për të marrë të drejtën që të ndërtojë dhe operojë këtë tubacion, do të jenë në bashkëpunim dhe koordinim me MIE, e cila pas paraqitjes së dokumentacionit nga ana e subjektit GPP Korça sh.p.k., do ta pajisë subjektin me autorizim për vazhdimin e procedurave dhe më tej do të vazhdohet me shqyrtimin dhe miratimin nga KM të lejes së posaçme për aktivitetin e ndërtimit dhe operimit të tubacionit.</p> <p>Hapat që duhet të ndjekë subjekti , për të marrë lejen për punimet ndërtimore për tubacionin, do të jenë në bashkëpunim dhe koordinim me MIE dhe AZHT, ku pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm teknik, do të procedohet me shqyrtimin e tij në KKT dhe do të lëshohet leja e ndërtimit për tubacionin e hgazit që do të lidhë TEC-in Korçë me tubacionin e projektit TAP.</p> <p>Gjithashtu, ndërtimi i linjës së gazit duhet ti nënshtrohet vleresimit të ndikimit në mjedis, pasi projekti ka nje</p>

		impakt të caktuar i cili duhet vlerësuar në mënyrë të detajuar dhe rekomanduar masat e nevojshme që duhen ndërmarrë për të shmangur ndotjen dhe dëmtimin e mjedisit.
Ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 400kv për transmetimin e energjisë elektrike nga Termocentrali deri në N/S Zëmbllak (gjatësi rreth 11 km)	<p>Rekomandohet PO nga MIE dhe PO me kusht nga MTM</p> <p>Ligji Nr. 43/2015, datë 30.04.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”,</p> <p>Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, si dhe të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.</p>	<p>Hapat që duhet të ndjekë subjekti për të marrë të drejtën që të ndërtuar dhe operuar këtë linjë elektrike, do të jenë në bashkëpunim dhe koordinim me MIE, e cila pas paraqitjes së dokumentacionit nga ana e subjektit GPP Korça sh.p.k., do ta pajisë subjektin me autorizim për marrjen e lejes së posaçme për aktivitetin e ndërtimit dhe operimit të linjes elektrike.</p> <p>Hapat që duhet të ndjekë subjekti, për të marrë lejen për punimet ndërtimore për linjen elektrike, do të jenë në bashkëpunim dhe koordinim me MIE dhe AZHT, ku pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm teknik, do të procedohet me shqyrtimin e tij në KKT dhe do të lëshohet leja e ndërtimit për linjen elektrike që do të lidhë TEC-in Korçë me N/S elektrik Zëmbllak.</p> <p>Sistemi i matjes së energjisë për të dyja daljet e reja të linjës do të jenë të pavarura nga Sistemi i Kontrollit dhe Sistemi i Monitorimit. Furnizimi i paisjeve që do të përdoren për faturimin e</p>

		<p>energjisë dhe shërbimi i stacionit të matjes do të kryhet nga OST sh.a. Pajisjet e sistemit të matjes së energjisë për dy daljet e linjës do të projektohen të tillë që të plotësojnë specifikimet teknike dhe të jenë në harmoni me sistemin ekzistues të matjes në N/S e Zemblakut dhe rrjetin e transmetimit në nivelin e Qendres Dispeçer.</p> <p>Edhe ky ndetim kërkon të vlerësohen në aspektin e impaktit që ka në mjedis.</p>
Ndërtimi i linjës së ujit nga Termocentrali deri në impiantin e trajtimit të ujit të qytetit	Rekomandohet PO me kusht nga MTM	Projekti duhet t'i nënshtrohet procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis
Ndërtimi i dy linjave (dërgimi dhe kthimi) për tranferimin e ujit të nxehtë	Rekomandohet PO me kusht nga MTM	Projekti duhet t'i nënshtrohet procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis
Kontratë për furnizimin me gaz nga TAP. Qeveria shqiptare të konsiderojë TEC Korçën si një konsumator potencial dhe ta përfshijë në kërkesën për sasinë e gazit që do të mbetet në Shqipëri.	Rekomandohet PO nga MIE, pasi subjekti ka hyrë vetë në bisedime me TAP	<p>Furnizimi me gaz i "Termocentralit të Gazit me Fuqi të Kombinuar", Korçë, parashikohet që të realizohet me sasi të gazit që do të transportohen nëpërmjet gazsjellësit TAP (por që do të jetë në pronësi të tregtarëve (furnizuesve) të gazit), pasi shoqëria TAP AG është një shoqëri që do të ketë një aktivitet të licencuar nga ERE vetëm për transportin e gazit.</p> <p>Qeveria Shqiptare të konsiderojë TEC Korçën si një konsumator potencial dhe ta përfshijë në kërkesën</p>

		<p>për sasinë e gazit që do të mbetet në Shqipëri, duke patur në konsideratë edhe dy marrëveshjet paraprake që ka bërë për marrje të sasive të gazit për tregun shqiptar në masën 250000 m³ nga shoqëria zviceriane AXPO (aktualisht aksionere e shoqërisë TAP AG), si dhe në masën 500 000 m³ nga shoqëria gjermane E-On Rhur gaz (ish shoqëri aksionere e shoqërisë TAP AG).</p> <p>Gjithsesi Qeveria Shqiptare do të mbështesë shoqërinë GPP Korça sh.p.k. për çdo mundësi tjetër furnizimi që do të jetë oportune, përfshirë edhe prodhimin në vend të sasive të nevojshme të gazit.</p>
<p>Marrëveshje me OST</p>	<p>MIE rekomandon PO</p>	<p>Lidhja me rrjetin shqiptar të transmetimit do të bëhet mbi bazën e një marrëveshje me OST sh.a..</p> <p>Termocentrali i ri i Korçës do të lidhet me një linjë 400 kV me dopio qark me nënstacionin ekzistues të energjisë elektrike të Zemblakut. Sistemi elektrik i Termocentralit do të projektohet duke u bazuar në konfigurimin me një bosht të Impiantit, duke patur vetëm një gjenerator dhe një transformator ngritës. Energjia elektrike e prodhuar tek gjeneratori me nivel tensioni 22 kV do të ngrihet në një nivel tensioni 400 kV tek transformatori dhe më pas do të kalojë në</p>

		<p>daljen 400 kV të linjës në Termocentral. Linja e TL 2x400 kV CCCPP Korçë – N/S Zemblak 400/110/20 kV, me gjatësi rreth 11 km do të ndërtohet nga shoqëria GPP Korça sh.a.k. dhe mbi bazën e një marrëveshje do ti transferohet në administrim dhe përdorim shoqërisë OST sh.a.</p>
--	--	--

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE
KRYEMINISTËR
EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DAMIAN GJIKNURI

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
ARBEN AHMETAJ

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
NIKO PELESHI

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
BLENDI KLOSI

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT
ALMA HICKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS